



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kuvendit
Nr. 03-400-654/2011



KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2012-2014

DRENAS, QERSHOR 2011

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2012-2014

Në përputhje me procedurat buxhetore 2012-2014, të dhëna nga Ministria për Financa dhe Ekonomi përmes Qarkores buxhetore 2012# 1- komunat , kërkohet përgatitja e dokumentit të Kornizës afatmesme buxhetore komunale. KAB komunale, paraqet një dokument të procesit për zhvillimin e buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, në mënyrë që demonstroi qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare.

Korniza afatmesme buxhetore komunale ofron një shpjegim të plotë të politikave /prioriteteve të tanishme dhe afatmesme të komunës, projeksionet lidhur me mënyrën në të cilën buxheti i komunës do të bëjë përmbushjen apo përkrahjen e prioritetëve, si dhe parashikimet rreth performancës ekonomike të komunës.

OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Me Kornizën afatmesme buxhetore 2012-2014 të Komunës së Drenasit, synohet të arrihen këto objektiva :

- a) zhvillimin ekonomik;
- b) planifikimin urban dhe rural;
- c) shfrytëzimin e tokës;
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- e) mbrojtjen e mjedisit lokal;
- f) formimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve, drenazheve, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transporti lokal;
- g) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- j) ofrimin e për kujdesit publik primar shëndetësor;
- k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për strehim familjar raste emergjente, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit;
- l) banimin publik;
- m) shëndetësinë publike;
- n) licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- o) emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- p) aktivitetet kulturore dhe të lira.

Seksioni 1 : Korniza ekonomike dhe fiskale

1.1. Korniza makro ekonomike

Korniza makroekonomike është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH).

Duke u bazuar në kornizën në fjalë dhe parametrat tjerë në lidhje me të hyrat dhe të dalurat në periudhën e ardhshme tri vjeçare planifikohet që sektorët e komunës do të kenë këto të hyra dhe të dala:

Sektorët kryesor	Aktuali	Projeksioni	Projeksioni provues	
	2011	2012	2013	2014
Sektori i Përgjithshëm	3.351.313	3.988.698	4.125.836	4.225.371
Sektori i Arsimit	4.734.208	4.306.766	4.306.766	4.311.866
Sektori i Shëndetësisë	1.290.654	1.175.037	1.176.037	1.177.037
Gjithsej:	9.376.175	9.480.501	9.618.639	9.714.274

Seksioni 1.2 : Perspektiva e politikave fiskale

Ky seksion bazohet në informatat dhe analizat e përfshira në Kornizën afatmesme të shpenzimeve për Kosovën 2012-2014. Veç kësaj , vëmendje e duhur i është kushtuar politikave fiskale (politikës së të ardhurave dhe politikës së shpenzimeve), zotimeve të Qeverisë së Kosovës të përfshira në Memorandumin e politikave ekonomike e fiskale.

Seksioni bënë prezantimin e shkurtër lidhur me mënyrën e zotimit të planifikuara të qeverisjes lokale, lidhur me politikat fiskale që ndikojnë në buxhetin e komunës. Këto do të jenë ndryshimet në kufijtë në mes të shpenzimeve operative (pagat+ mëditjet dhe mallrat + shërbimet), si dhe shpenzimeve kapitale, që do ta kenë efektin e përmirësimit të infrastrukturës në njërin anë, si dhe për kushtet e mundshme në drejtim të rritjes së arkëtimit të taksave, ngarkesave dhe tatimit në pronë. Të gjitha këto do të jenë si rezultat i ngritjes dhe promovimit të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektshmerisë.

Sistemi i të hyrave parashihet të funksionoi nga tri burime kryesore të financimit:

- Transferet nga buxheti qendror në formë të granteve dhe
- Të hyrat nga burimet vetanake dhe
- Grantet nga Donatorët dhe Bashkë-financuesit.

Grantet do të jenë si:

- granti i përgjithshëm,
- granti për arsim ,
- granti për shëndetësi-shërbime sociale, si dhe
- grantet - transferet e tjera.

Të hyrat nga burimet vetanake, planifikohen të realizohen nga:

- tatimi në pronë,
- licencat,
- taksat- ngarkesat e ndryshme ,
- të hyrat nga pasuria dhe
- gjobat e ndryshme.

Të hyrat nga donatorët dhe bashkë financimi, planifikohen të realizohen nga:

- Grandet e donatorëve të ndara për projekt të ndryshme,
- participimet e qytetarëve dhe bashkëfinancimi për projekte të ndryshme.

Shkalla mesatare e mbledhjes së të hyrave vetanake, planifikohet të rritet për 8,82% gjatë viteve në vijim krahasuar me vitin 2011.

Për periudhën e ardhshme tri vjeçare planifikohet rritja e të hyrave duke u bazuar në këta faktor:

- (i) ekzistimi i borxheve të bartura,
- (ii) implementimi i instrumenteve ligjore për zbatim,
- (iii) mbledhja e qirasë për shfrytëzimin e pronës komunale nga ndërmarrjet ose personat fizik ,
- (iv) të hyrat e tatimit në pronë dhe
- (v) taksat – ngarkesat tjera

Për të bërë planifikimin dhe shpërndarjen e drejtë për të dalat publike me Kornizën afatmesme buxhetore komunale 2012-2014, në mënyrë të saktë egëzistojnë vështirësi ngase se mungojnë tregues të saktë zhvillimor.

Në drejtim të shpërndarjes dhe planifikimit të drejtë të parasë publike në këtë vit është përdorur në nivel të Kosovës, formula me të cilën janë paraparë indikatorët – kriteret për shpërndarjen e granteve.

Për shpërndarjen e Grantit të përgjithshëm në nivel të Kosovës kanë shërbyer këta indikator:

- popullsia e komunës,
- sipërfaqja e komunës,
- komunat e minoriteteve,
- popullsia e minoriteteve në komunë dhe
- shuma fikse për komuna.

Për shpërndarjen e Grantit specifik për arsim në nivel të Kosovës kanë shërbyer këta indikator:

- numri i shkollave në komunë,
- numri i nxënësve në shkolla fillore,
- numri i nxënësve në shkolla të mesme,
- numri i nxënësve shumicë si dhe
- numri i nxënësve pakicë.

Për shpërndarjen e Grantit specifik për shëndetësi në nivel të Kosovës kanë shërbyer këta indikator:

- popullsia në komunë dhe
- numri mesatar i kontrolleve për kokë banori.

Në bazë të kriterëve të përcaktuara me parë është planifikuar që ndarja e ganteve do të bëhet në mënyrë të drejtë dhe do i përmbush të gjitha nevojat fiskale për tri sektorët në nivel komunal.

Seksioni 1.3: Parashikimi i të hyrave komunale

Seksioni nr.1.3, prezanton tërë pakon e të hyrave publike të planifikuara si mundësi financuese për shpenzime komunale dhe atë për tri vitet e ardhshme. Bazë për planifikimin e të hyrave, ka shërbyer Qarkorja buxhetore 2012/#1 – komunat e lëshuar nga MEF, ku janë paraqitur kufinjët e granteve të aprovuara nga Komisioni i Shëndetësi; si dhe parashikimi i të hyrave vetanake të komunës sipas fushave kryesore të hyrave duke u bazuar në politikat e të hyrave të komunës.

Ky seksion përfshin tabelën e cila prezanton planifikimin e të hyrave të komunës nga të gjitha burimet, në bazë të fushave kryesore të hyrave për tri vitet e ardhshme duke prezantuar edhe vitin aktual 2011.

Tabela 1. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale

Nr.	Burimi i të hyrave	Aktual 2011	Projeksioni		
			2012	2013	2014
1.	Gjithsej Grantet				
	ndërqeveritare	8.728.506	8.356.237	8.475.613	8.551.788
2.	Gjithsej të hyrat vetanake të komunës	647.669	804.228	813.026	822.486
	Të hyrat e Administratës	550.469	671.228	679.026	682.386
	-Lejet-licencat direkte komerciale dhe bizneset-lejet:	76.000	78.000	79.000	80.000
	-Licencat për lojërat zbavitëse, etj	3.000	3.100	3.200	3.300
	-Licencat profesionale,	7.000	8.000	9.000	10.000
	-Licencat për shfrytëzimin e tokës dhe për ndërtim,	70.000	71.000	72.000	74.000
	-Inspektimi i tokës dhe aktivitetet gjeodezike,	40.000	41.000	42.000	43.000
	-Shërbimet e inspektimit dhe të shëndetësore	8.000	9.100	9.200	9.300

	-Shfrytëzimi i tokës komunale,	25.000	25.000	25.000	25.000
	-Pagesat për vetura,	70.000	75.000	80.000	85.000
	-Certifikatat dhe dokumentacionet tjera,	40.000	55.729	56.000	63.250
	-Taksat pronësore	136.469	229.299	232.926	210.536
	-Të tjera	30.000	30.000	30.500	31.000
	 -Të hyrat e admin.Kom.-inderekte (Gjobat e trafikut nga SHPK)	 45.000	 46.000	 40.200	 48.000
3.	Të hyrat në Arsim	28.000	63.000	63.000	68.000
4.	Të hyrat në Shëndetësi	69.200	70.000	71.000	72.000
5.	Grantet e donatorëve edhe Bashkë-financuesit		320.000	330.000	340.000
	Gjithsej të hyrat:	9.376.175	9.480.501	9.618.639	9.714.274

Seksioni 2: Vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore

Planifikimi i të dalave – shpenzimeve publike për vitet 2012-2014, do të bëhet sipas Metodës së Buxhetimi Programor. Metoda e Buxhetimit programor, kërkon që shpenzimet të planifikohen për nga funksioni në programe, nën-programe të përcaktuara me Statutin e Komunës, por të bazuara në projekte, ndërsa për kah funksioni shpenzimet do të planifikohen në pesë kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve, në pajtim me rregullat financiare për shpenzimet (SIMFK) të nxjerra nga Departamenti i Thesarit pranë MEF-it, dhesi vijon:

- paga dhe mëditje,
- mallra dhe shërbime,
- shpenzime të shërbimeve komunale,
- subvencione-transfere dhe
- shpenzime kapitale.

Tabela 1. KËRKESAT PËR BUXHETIN 2012-2014 SIPAS PROGRAMEVE

Viti 2012

Nr.	Programet	Paga- Med.	Mallra-Shër.	Shë.Kom.	Subven.	Inves. Kapit.	Gjithsej:
1	Drejt. për Administ. dhe Pers.	196.260	90.000	46.900	5.600	100.000	438.760
2	Drejt. për Katastër-Gjeodezi	58.199	8.960	360		50.000	117.519
3	Drejt. për Buxhet dhe Financa	67.065	11.820	360		25.000	104.245
4	Drejt. për Bujqësi dhe Zhvillim	59.610	30.300	360	90.000	25.000	205.270
5	Drejt. për Arsim	4.200.509	316.000	87.000	90.000	17.000	4.710.509
6	Drejt. Për Shënd. dhe Mirëq.	920.000	188.000	43.810	20.000	130.000	1.301.810
7	Drejt. për Mbr. Ambj. Dhe Urban.	52.986	15.030	360		1.495.597	1.563.973
8	Drejt.përKultur,Rini dhe Sport	71.996	43.280	360	50.000	150.000	315.636
9	Drejt. për Shërb. Pub. Dhe Emer	109.845	44.000	2.790	10.000	150.000	316.635
10	Drejt. për Inspekcion	51.000	15.000	360			66.360
11	Zyra e Kryetarit	67.992	36.000	1.500	20.000		125.492
12	Zyra e Kuvendit	106.136	6.000	400			112.536
13	Zyra për Kominitete	15.396	6.000	360		80.000	101.756
	Gjithsej:	5.976.994	810.390	184.920	285.600	2.222.597	9.480.501

Viti 2013

Nr.	Programet	Paga- Med.	Mallra-Shër.	Shë.Kom.	Subven.	Inves. Kapit.	Gjithsej:
1	Drejt. për Administ. dhe Pers.	200.460	152.760	57.900	6.000	145.000	562.120
2	Drejt. për Katastër-Gjeodezi	58.199	7.760	360		48.000	114.319
3	Drejt. për Buxhet dhe Financa	67.065	11.820	360			79.245
4	Drejt. për Bujqësi dhe Zhvillim	5.960	31.100	360	90.000		127.420
5	Drejt. për Arsim	4.318.509	347.400	88.720	20.000		4.774.629
6	Drejt. Për Shënd. dhe Mirëq.	969.286	241.480	47.895	25.000	20.000	1.303.661
7	Drejt. për Mbr. Ambj. Dhe Urban.	52.968	15.340	360		1.313.175	1.381.843
8	Drejt.përKultur,Rini dhe Sport	71.996	47.430	360	38.000	320.000	477.786
9	Drejt. për Shërb. Pub. Dhe Emer	109.845	45.080	2.790	10.000	260.000	427.715
10	Drejt. për Inspekcion	51.000	29.520	360			80.880
11	Zyra e Kryetarit	70.564	46.570	1.500	20.000		138.634
12	Zyra e Kuvendit	106.136	7.460	400			113.996
13	Zyra për Kominitete	10.986	16.045	360		9.000	36.391
	Gjithsej:	6.092.974	999.765	201.725	209.000	2.115.175	9.618.639

Viti 2014

Nr.	Programet	Paga- Med.	Mallra-Shër.	Shë.Kom.	Subven.	Inves. Kapit.	Gjithsej:
1	Drejt. për Administ. dhe Pers.	196.660	146.150	59.000	6.800		408.610
2	Drejt. për Katastër-Gjeodezi	58.199	7.760	360			66.319
3	Drejt. për Buxhet dhe Financa	67.065	11.820	360			79.245
4	Drejt. për Bujqësi dhe Zhvillim	59.610	32.600	360	90.000		182.570
5	Drejt. për Arsim	4.318.509	349.818	88.720	20.000		4.777.047
6	Drejt. Për Shënd. dhe Mirëq.	969.286	228.694	52.284	25.000	30.000	1.305.264
7	Drejt. për Mbr. Ambj. Dhe Urban.	52.986	15.330	360		1.753.971	1.822.647
8	Drejt.përKultur,Rini dhe Sport	71.996	48.330	360	53.000	100.000	273.686
9	Drejt. për Shërb. Pub. Dhe Emer	109.845	45.080	2.790	10.000	260.000	427.715
10	Drejt. për Inspekcion	51.000	29.950	360			81.310
11	Zyra e Kryetarit	70.564	46.570	1.500	20.000		138.634
12	Zyra e Kuvendit	106.136	7.460	400			113.996
13	Zyra për Kominitete	11.091	16.780	360		9.000	37.231
	Gjithsej:	6.142.947	986.342	207.214	224.800	2.152.971	9.714.274

Katër kategoritë e para të shpenzimeve njihen si shpenzime operative të cilat me Qarkoren Buxhetore të MEF-it janë të limituara, për dallim nga kategoria e pestë e cila s'do të këtë kufizime. Maksimumi i rritjes së lejueshme të shpenzimeve operative do të jetë i kufizuar dhe i përcaktuar me Qarkoren e dytë Buxhetore të MEF-it e cila pritet të shpërndahet nga mesi i korrikut.

Numri i financiar të punësuarve me Buxhetin Komunal 2012 është i lejueshëm deri në 1307 punëtorë. Shpenzimet operative edhe gjatë viteve në vijim do të kontrollohen në mënyrë rigorozë dhe çdo here të shkohet në zvogëlimin e tyre në at mënyrë që shpenzimet për investime kapitale të jen nga viti në vit në rritje.

Si tani ashtu edhe në të ardhmen do ti kushtohet kujdes Implementimit më efektiv të shpenzimeve kapitale publike dhe shfrytëzimi i iniciativave të llojit të partneritetit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat dhe ky do të jetë synim kryesor për vitet në vijim.

Ndarja sektoriale e shpenzimeve në vitin 2012 planifikohet si vijon:

- sektori i përgjithshëm duke u bazuar në burimin e të hyrave, planifikohet të marr pjesë në buxhet me shpenzime për 42.10%
- sektori i arsimit planifikohet të marr pjesë në buxhet me shpenzime me 45.50% dhe
- sektori i shëndetësisë dhe i mirëqenës sociale planifikohet që të marr pjesë në buxhet me shpenzime për 12.40%

Në Strategjinë Fiskale 2012-2014, në Sektorin e Arsimit, norma e financimit është me e ultë se në vitet e mëparshme, por kjo është faza fillestare e buxhetimit. Komuna në procedurat e buxhetimit do të analizoi mirë këtë buxhet dhe nëse nuk ka Grantë shtesë nga Qeveria e Kosovës, atëherë nevojat e financimit do të financohen nga Granti i përgjithshëm i komunës. Procesi buxhetor do të shërben si mjet për ofrimin e politikave të drejta financiare me prioritet të arsyeshme që është për përfitimet e qytetarëve të Komunës së Drenasit.

Seksioni 2.2: Strategjia zhvillimore për sektorët komunal

Komuna ka të përgatitur dhe të aprovuar Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe në të është cekur vizioni për të ardhmen; "Komuna e Drenasit do të këtë infrastrukturë të përmirësuar fizike dhe mjedis të mbrojtur natyror, ambient të përshtatshëm për zhvillimin e bizneseve, bujqësi intensive, rritje të punësimit, ngritje të nivelit të arsimit dhe të edukimit sipas nevojave të tregut, shërbime cilësore publike, shëndetësore dhe administratë lokale më efikase"

Komuna në tri vitet e ardhshme do të këtë këto objekte për realizim dhe njëherit do të financoi tërësisht apo pjesërisht ato si vijon:

Objektivat:

- a. shtimi i efikasitetit në punë që ndikon në zhvillimin ekonomik
 - i. përmirësimi i kushteve për shërbime publike,
 - ii. përmirësimi i efikasitetit në shpenzimet e parave publike,
 - iii. shfrytëzimi maksimal i burimeve të mundshme,
 - iv. kryerja e punëve me kohë dhe në mënyrë të duhur.

b. rritja e shpejtë e të ardhurave

- i. shkalla më e lartë e arkëtimit të tarifave dhe ngarkesave
- ii. insistimi në zgjerimin e fushave kryesore për të hyrat,
- iii. ngarkesa të reduktuara me tarifa të zgjeruara,

c. të sigurohet disiplina financiare

- i. pajtueshmëri me politiken financiare, rregullat, rregulloret dhe me udhëzimet ,
- ii. ekzistenca e kontroleve interne,
- iii. transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik
- iv. analiza e shpenzimeve ,
- v. evidencë e duhur financiare dhe kontabël,
- vi. Inventarizim i duhur dhe menaxhim i pronës,
- vi. përmirësim i politikës së prokurimit dhe iprocedurav.

d. forumi ekonomik

- i. zhvillimi i strategjisë komunale për promovim ekonomik,
- ii. krijimi i kushteve për interesimet e investitorëve ,
- iii. nxitja e mundësive bankare / mikro kredive ,
- iv. plani për zhvillimin e viseve rurale,
- v. marketingu i potencialit zhvillimor të komunës për mesë zyrës së biznesit
- vi vendosja e forumit ekonomik.

Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat:

- a. Përgatitja e planit të punës 2012-2014
- b. Zbatimi i planit zhvillimor komunal dhe urban (2009-2020),
- c. Përgatitja e planit urbanistik,
- d. Përgatitja e kornizës afatmesme të shpenzimeve 2012-2014
- e. Përmirësimi i mbledhjes thelbësore të të dhënave dhe përdorimi,
- f. Shqyrtimi i përgjegjësive dhe obligimeve komunale,
- g. Kujdesi ndaj palës (menaxhimi i mirë i zyrës pritëse),
- h. Zbatimi më përpikëri i ligjeve, rregulloreve dhe vendimeve në fuqi,
- i. Vendosja e pajisjeve për tërë stafin- Interneti,
- j. Menaxhimi, monitorimi dhe vlerësimi i projekteve.

Për faktin së Komuna e Drenasit, hynë në radhën e komunave më të pa zhvilluara, kërkohet një financim shtesë ose nga Qeveria e Kosovës ose nga donatorët e jashtëm në at mënyrë që sa do pak të përmisohet infrastruktura në nivel komunal. Kur thuhet përmasimi i infrastrukturës merret parasysh edhe dëmi i cili ka ndodhur gjatë luftës dhe duhet rindërtuar.

Ne tani, komuna përballlet me një zhvillim më të shpejtë ekonomik e sidomos në Sektorin Privat të cilit sektor duhet ti sigurohen kushte të mirëfillta dhe të bazuara në ligje dhe mos të jen të rrezikuara investimet e këtij sektori.

Komuna me organet- administratën duhet mbështetur në forma të ndryshme e sidomos duhet mbështetur bizneset e vogla dhe të mesme që do të ndikoi në zhvillimin ekonomik të komunës dhe në zvogëlimin e papunësisë..

Në zvogëlimin e pa punësisë në komunën tonë do të ndikoi edhe investimi i punëtorëve tan të cilët janë të punësuar në dijaspor. Paratë e dërguara nga diaspora janë një prej burimeve kryesore të hyrave për një numër të madh të familjeve, edhe pse ka një rënje nga e kaluara. Paratë e dërguara nga diaspora kanë ndikuar shumë në rindërtimin e shtëpive të banimit ekonomive familjare, gjë e cila mund të shihet ku do në teritorin e komunës.

Me krijimin e kushteve më të favorshme dhe përkrahjen teknike që do ta japi zyra për këshilla për biznes, ndoshta do të intensifikoj interesimin e diasporës sonë për investime në Drenas.

Edhe pse është kryer regjistrim i popullsisë, ende nuk është zyrtar por në bazë të disa indikatorëve shihet se Komuna e Drenasit do të ketë mbi 60.000 banorë.

Në bazë të disa vlerësimeve supozohet se në një familje mesatarisht jetojnë prej: 5 deri në 9 anëtarë në një familje. Sa i për ketë të hyrave familjare mesatar në komunë nuk egëzistojnë shënimet e sakta por edhe këtu vlerësohet se mesatarja e të hyrave vjetore për familje është 2.500 € .

Spektori financiar, e veçmas sistemi bankar si komponent më e rëndësishme e tij pas lufte sidomos në tri vitet e fundit vazhdoi të tregon trend pozitiv të rritjes. Bankat komerciale kanë hapur përfaqësitë e tyre në Drenas, dhe tani transaksionet financiare bëhen kryesisht përmes sistemit bankar që është një lehtësim si për sektorin privat ashtu edhe për individët. Bankat komerciale, kanë treguar një gatishmëri të madhe për dhënjen e kredisë, por dihet se kushtet e kredisë janë të pa favorshme për zhvillimin e biznesit dhe është vërejtur dukuria tjetër jo pozitive se shfrytëzimi i kredisë nga sektori privat bëhet kryesisht në degën ekonomike të tregtisë e jo në drejtim të ndërmarrjeve prodhuese.

Ne kemi nevojë për të vendosur një sistem të fuqishëm të menaxhimit të informatave pasi që informatat janë vitale për marrjen e vendimeve. Instalimi i pajisjeve moderne teknologjike, pastaj trajnimi i punëtorëve si dhe përpunimi i të dhënave në baza të rregullta janë aktivitetet kyçe të cilat kërkojnë vëmendje urgjente edhe në këtë periudhë.

Seksioni 3: Programi komunal i investimeve publike (PIP)

Projektet e regjistruara në sistemin PIP-it , janë të përgatitura nga drejtoratet-programet të bazuara në nevojat e qytetarëve të komunës dhe subjekteve tjerë. Këto projekte dhe projektet tjera të propozuar, gjatë proceseve buxhetore do të analizohen, shqyrtohen dhe në fund do të aprovohen në kuvend në bazë të mundësisë reale buxhetore që ka komuna për financim gjatë viteve 2012-2014.

Lista përfundimtare e projekteve në fund të proceseve buxhetore do të aprovohet në kuvend dhe është pjesë përbërëse e këtij dokumenti .



KRYESËSI I KUVENDIT
Fatmir Istogu